



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr/55 /2011

Në bazë të nenit 12.2(c) dhe, nenin 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03L-040 Gazeta Zyrtare Nr.28/2008, Konventës për të Drejtat e Fëmijëve të miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, nenit 9, 9.6, 9.7 të Ligjit për Duhanin Nr.02/L-36, nenit 61, 61.1, 61.2 të Ligjit për Veprimtari Hoteliere Nr.2004/16, neni 32.5 të Statutit të Komunës, nenit 15.1 (a) të Rregullores së Punës së Kuvendit. Kuvendit i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2011 merr këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E RREGULLORËS PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURIT QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE

I

Aprovohet Rregullorja me numër 01Nr.55/2011 në tekstin e mëtejme: Rregullorja për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre, e cila ka për qëllim mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin e tyre.

II

Rregullorja e përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi është hartuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e përmbledhur në gjithsej 9 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesët: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

IV

Rregullorja hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

V

Më këtë Vendim njoftohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.06.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

